



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 1800 prot.

Tiranë, më 8.05.2023

**Lënda:** Përcillet vendimi i AMA-s mbi monitorimin e fushatës zgjedhore për periudhën 1-5 maj 2023

**Z. ILIRJAN CELIBASHI,**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
*Adresa:* Rruga "Ibrahim Rugova", Nr. 4, Tiranë

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), në cilësinë e autoritetit rregullator që monitoron pasqyrimin e fushatës zgjedhore në subjektet ofrues të shërbimit audioviziv (OSHMA), sipas neneve 77-85 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe në zbatim të dispozitave të vendimit nr 2, datë 30.01.2021 të Komisionit Rregullator të KQZ "Mbi metodologjinë e monitorimit të medias audio dhe audiovizive", përcjell në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

- Vendimin e AMA nr 37, datë 08.05.2023 "Për shqyrtimin e raportit të mbulimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të për periudhën 1-5 maj 2023".
- Tabelat përmbledhëse për pasqyrimin e fushatës zgjedhore në periudhën 28 prill - 4 maj 2023.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

**Ronelda RRAPOLLARI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Nr 1803 prot.,

Tiranë, më 08.05 .2023

VENDIM

NR. 37, DATË 08.05.2023

PËR

SHQYRTIMIN E RAPORTIT TË MBULIMIT TË FUSHATËS ZGJEDHORE NGA  
OSHMA-TË PËR PERIUdhËN 1-5 MAJ 2023

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), i përbërë nga:

|         |          |                 |
|---------|----------|-----------------|
| Armela  | Krasniqi | Kryetar         |
| Desada  | Metaj    | Zëvendëskryetar |
| Aurela  | Bicja    | Anëtar          |
| Besian  | Zogaj    | Anëtar          |
| Gjergji | Hamiti   | Anëtar          |
| Jetmir  | Halilaj  | Anëtar          |
| Joana   | Allushi  | Anëtar          |

Pasi mori në shqyrtim çështjen me:

**Kërkues:** AMA, kryesisht

**Objekt:** Shqyrtimi i raportit të mbulimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të për periudhën 1-5 maj 2023

**Bazë ligjore:** Neni 19, pika 16 e ligjit nr. 97/2013, datë 19.03.2013 “Për mediat audiovizive në RSH”, të ndryshuar, nenet 77-85 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 2, datë 30.01.2021, të Komisionit Rregullator të KQZ-së “Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të medias audio dhe audiovizive”.

## VËREN SE:

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), në mbështetje të nenit 85 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimit nr. 2 të Komisionit Rregullator të KQZ-së, datë 30.01.2021 “Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të medias audio dhe audiovizive”, është ngarkuar me monitorimin e fushatës zgjedhore.

Sipas pikave 1 - 4 të nenit 85 të Kodit Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar:

1. Monitorimi i fushatës zgjedhore në mediat audiovizive kryhet nga enti rregullator që rregullon dhe mbikëqyr fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive. Monitorimi kryhet në të gjithë territorin ku zhvillohen zgjedhjet.
2. Enti rregullator që rregullon dhe mbikëqyr veprimtarinë e operatorëve radiotelevizivë monitoron zbatimin e rregullave të këtij ligji dhe të akteve nënligjore me karakter normativ të KQZ-së nga operatorët radiotelevizivë dhe nga subjektet zgjedhore.
3. Jo më vonë se 3 muaj para datës së zgjedhjeve KQZ miraton dhe publikon Metodologjinë e Monitorimit të Medias.
4. Enti rregullator i pasqyron gjetjet e veta në raporte të detajuara, minimalisht të përjavshme, të cilat ia paraqet KQZ-së për kompetencë. Raportet shoqërohen, sipas rastit, me propozimet për masa administrative. Raportet e monitorimit të medias publikohen në faqen e internetit të KQZ-së menjëherë sapo depozitohen në KQZ. Përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore kanë të drejtë të depozitojnë komentet dhe propozimet e tyre para KQZ-së, të cilat shqyrtohen bashkë me raportin.

Gjithashtu, sipas neneve 9 dhe 10 të metodologjisë së monitorimit të medias audio dhe audiovizive, përcaktohet se raportet e monitorimit të realizuara nga AMA do t’i paraqiten KQZ-së. Sipas pikës 2 të nenit 10 të po këtij akti, parashikohet se “AMA i pasqyron gjetjet e tij në raporte të detajuara sasiore dhe cilësore, minimalisht një herë në javë, të cilat ia paraqet KQZ-së për kompetencë”.

Në monitorim të përhershëm nga AMA janë 24 OSHMA, për të cilat është njoftuar KQZ-ja nëpërmjet shkresës së AMA-s nr. 1516 prot., datë 11.04.2023. Po në këtë shkresë, AMA ka njoftuar edhe për 29 OSHMA të tjera, monitorimi i të cilave po bëhet me përzgjedhje javore.

Informacioni mbi OSHMA-të të cilat po monitorohen nga AMA në mënyrë të përhershme dhe në baza javore, është përcjellë paraprakisht edhe pranë Këshillit të AMA-s, me shkresën nr. 1513 prot., datë 11.04.2023.

Si më poshtë vijon, gjendet lista e OSHMA-ve të monitoruara në javën e tretë të fushatës zgjedhore, në datat 28 prill – 4 maj 2023.



**Tabela I**

| <b>Nr.</b> | <b>Kanali</b>    | <b>Zonë mbulimi</b> |
|------------|------------------|---------------------|
| 1.         | Rtsh Gjirokastra | Gjirokastër         |
| 2.         | Tv Channel 7     | Gjirokastër         |
| 3.         | One Tv Vlora     | Vlorë               |
| 4.         | Zjarr Tv         | Tiranë              |
| 5.         | Tv1 Channel      | Shkodër             |
| 6.         | Tv Lezha         | Lezhë               |
| 7.         | Bulevard Tv      | Durrës              |
| 8.         | Tv Klaudiana     | Peqin               |

Në bazë të metodologjisë së sipërcituar, gjatë kësaj periudhe, AMA ka përcjellë raportet ditore të monitorimit për këto OSHMA, me të dhënat si më poshtë vijon:

- Kohën e monitorimit të secilit OSHMA, për transmetimet në orën 08.00-24.00;
- Minutazhin e transmetimeve për secilin subjekt zgjedhor;
- Hapësirën për çdo subjekt politik;
- Radhën e vendosjes së kandidatëve në edicionet informative;
- Transmetimet e drejtpërdrejta (*live*);
- Raportin gjinor sa i takon mbulimit mediatik të kandidatëve.

#### **I. Pasqyrimi i aktiviteteve të shpallura “Ndaluar nga KQZ”:**

Për periudhën që raportohet, AMA nuk ka pritur asnjë njoftim nga KQZ, i cili të përmbante vendime të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për ndalimin e veprimtarive të shpallura të “Ndaluar nga KQZ”.

#### **II. Depozitimi i regjistrimeve në AMA:**

Pika 6 e nenit 85 të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, parashikon se *radiot dhe televizionet publike dhe private janë të detyruara të regjistrojnë të gjitha transmetimet e tyre përgjatë gjithë periudhës së fushatës zgjedhore. Këto regjistrime ruhen deri në mbarimin e dhjetë muajve nga data e zgjedhjeve dhe vihen, me kërkesë të KQZ-së, menjëherë në dispozicion të saj.*

Detyrimi për depozitim ditor të përmbajtjeve audiovizive parashikohet edhe në metodologjinë e monitorimit të medias të sipërcituar, ku thuhet se “*OSHMA-të vendore që nuk mbulohen nga mjetet*



monitoruese janë të detyruara të depozitojnë pranë AMA-s përmbajtjen e transmetuar në fillim të çdo dite pasardhëse monitoruese”.

OSHMA-të si Glob TV, Channel 7, TV 1 Channel, TV Klaudiana dhe Saranda TV, nuk kanë paraqitur regjistrimet pranë AMA-s nga data 1-5 maj 2023.

**Propozim:**

**AMA i propozon KQZ-së që për këto 5 (pesë) OSHMA të procedohet me marrje mase administrative, sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar.**

**III. Të dhënat mbi edicionet informative:**

Neni 80, pika 2 e Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, parashikon se: *2. Radiotelevizioni publik e pasqyron fushatën zgjedhore nëpërmjet lajmeve dhe programeve informative, në përputhje me parimet e paanshmërisë, plotësisë, vërtetësisë dhe pluralizmit të informacionit, të parashikuara në legjislacionin që rregullon fushën e mediave elektronike....”*

Gjithashtu, në mbështetje të pikës 1 të nenit 81 të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, i cili parashikon se: *“në minutazhin politik të edicioneve informative, radiotelevizioni publik (RTSH) është i detyruar të zbatojë raporte kohore të barabarta për të gjitha partitë parlamentare, që në zgjedhjet e fundit për Kuvendin kanë marrë deri në 20 për qind të vendeve në Kuvend. Partitë që kanë marrë më shumë se 20 për qind të vendeve në Kuvend, përfitojnë kohë transmetimi të shpërndarë në mënyrë të barabartë midis tyre. Secila nga këto parti përfiton kohë sa dyfishi i kohës që përfiton një parti që ka marrë deri në 20 për qind të vendeve në Kuvend”.* I njëjti parashikim zbatohet edhe për OSHMA-të private.

**Në Tabelën nr. 1 të Shtojcës nr. 1 bashkëlidhur**, pasqyrohet koha e plotë e subjekteve politike e pasqyruar në edicionet informative të subjekteve audio dhe audiovizive që janë në monitorim të përhershëm, përgjatë periudhës 30 ditore të fushatës zgjedhore, që përfshin datat 14 prill – 5 maj 2023, ku përfshihet edhe periudha që po raportohet.

**Propozim:**

**Referuar të dhënave sipas Tabelës nr. 1 në Shtojcën nr. 1, për edicionet informative, AMA i propozon KQZ-së që të procedohet me masë administrative për radiotelevizionin publik (RTSH) për mosrespektim të raporteve kohore të barabarta për të gjitha partitë parlamentare, sipas mbulimit konkret që i kanë bërë fushatës zgjedhore në periudhën 14 prill - 5 maj 2023, sipas dispozitave të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar.**

**Propozim:**

Referuar të dhënave sipas Tabelës nr. 1 në Shtojcën nr. 1, për edicionet informative, AMA i propozon KQZ-së që OSHMA-të private sipas mbulimit konkret që i kanë bërë fushatës në periudhën 14 prill - 5 maj 2023, të bëjnë në vijim kompensimin në kohë transmetimi, në edicionet informative për efekt balancimi.

OSHMA-të duhet t'i referohen edhe përmbajtjes së shkresës nr. 3710 prot., datë 12.04.2023, që Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve u ka dërguar, me lëndë "Mbi disa rregulla që duhet të zbatohen nga operatorët radiotelevizivë privatë gjatë fushatës zgjedhore".

Në Tabelën nr. 1/1 të Shtojcës nr. 1 bashkëlidhur, jepen të dhëna mbi kohën e sinkroneve (në edicionet e lajmeve) të protagonistëve të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të në monitorim të përhershëm, periudha 14 prill - 5 maj 2023.

**IV. Të dhënat mbi emisionet:**

Në Tabelën nr. 2, të paraqitur në Shtojcën nr. 1 bashkëlidhur, jepen të dhënat përmbledhëse për periudhën 14 prill – 5 maj 2023, mbi kohën që iu kanë dhënë OSHMA-të në monitorim të përhershëm subjekteve politike në emisione dedikuar fushatës zgjedhore në fjalë.

**V. Të dhënat mbi reklamën politike:**

Në mbështetje të pikave 4 - 5 dhe 7 të nenit 84 të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, parashikohen kriteret ligjore për transmetimin e reklamës politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore. Ky nen parashikon se "4. Vetëm subjektet zgjedhore të regjistruara për zgjedhje kanë të drejtë të transmetojnë reklama politike gjatë periudhës zgjedhore në radiot, televizionet apo mediat audiovizive private, qofshin këto numerike, kabllore, analoge, satelitore apo të çdo lloj forme dhe mënyre të transmetimit të sinjalit. Reklammat politike të koalicioneve zgjedhore llogariten brenda kohës së partive politike anëtare të koalicionit, sipas marrëveshjes individuale të secilës parti me operatorin radioteleviziv. Reklama politike duhet të identifikojë qartë subjektin porositës. Në rast se reklama politike nuk është identifikuar qartë, KOZ-ja urdhëron pezullimin e menjëhershëm të transmetimit të saj derisa të bëhet identifikimi i kërkuar nga kjo pikë."

5. Koha e përgjithshme e transmetimit të reklamave politike gjatë gjithë fushatës zgjedhore nga secila radio dhe televizion privat nuk mund të jetë më shumë se 90 minuta për secilën parti të regjistruar për zgjedhje



7. Reklammat politike të subjekteve zgjedhore transmetohen ndërmjet intervaleve kohore nga ora 15.00 deri 18.00 dhe nga ora 21.00 deri 24.00 të programit ditor.”

**Në Tabelën nr. 3 të Shtojcës nr. 1 bashkëlidhur, jepen të dhënat përmbledhëse mbi transmetimin e reklamave politike prej OSHMA-ve gjatë periudhës 14 prill – 5 maj 2023:**

OSHMA-të Shijak TV dhe Syri TV, siç pasqyrohet në këtë tabelë, e kanë tejkaluar kohën prej 90 minutash për njërin prej subjekteve zgjedhore konkurruese. Konkretisht, koha për OSHMA-në Shijak TV është 298.32 min, ndërkohë që për OSHMA-në Syri TV është 18.97 min.

**Propozim:**

**AMA i propozon KQZ-së që t'i kërkojë këtyre 2 (dy) OSHMA-ve ndërprerjen e transmetimit të reklamave politike përtej minutazhit të përcaktuar e të lejuar në Kodin Zgjedhor, të ndryshuar.**

OSHMA-të, të cilat kanë transmetuar reklama politike jashtë kohës së përcaktuar nga Kodi Zgjedhor, i ndryshuar, janë si më poshtë vijon:

- Shijak TV - datë 1 maj (12 herë), datë 2 maj (2 herë), datë 3 maj (14 herë), datë 4 maj (9 herë), datë 5 maj (11 herë).
- Fax News - datë 2 maj (1 herë), datë 4 maj (1 herë).
- Syri TV – datë 2 maj (1 herë).
- Klan Plus – datë 3 maj (1 herë).
- Vizion Plus – datë 3 maj (1 herë), datë 4 maj (2 herë), datë 5 maj (2 herë).
- TV Bulqizë – datë 5 maj (12 herë).

AMA, në raportet ditore, ka raportuar në KQZ oraret konkrete të transmetimit të reklamave politike jashtë kohës së lejuar.

**Propozim:**

**AMA i propozon KQZ-së t'i kërkojë këtyre 6 (gjashtë) OSHMA-ve që të ndërpresin transmetimin e reklamave politike në kohën e ndaluar.**

AMA ka identifikuar që OSHMA-ja Syri TV ka transmetuar reklamë politike në edicionin e lajmeve, konkretisht më datë 2 maj (1 herë), më datë 3 maj (6 herë) dhe më datë 4 maj (6 herë).

**Propozim:**



**AMA i propozon KQZ-së t'i kërkojë OSHMA-së që të ndërpresë transmetimin e reklamave politike brenda edicionit të lajmeve.**

Gjithashtu, AMA ka identifikuar që OSHMA-ja Bulqiza TV ka transmetuar më datë 5 maj, ora 15.00, edicionin e lajmeve të një OSHMA-je tjetër (konkretisht ABC News).

#### **VI. Të dhëna mbi raportimin e përfaqësimit gjinor në fushatë:**

**Tabela nr. 4 e Shtojcës nr. 1 (bashkëlidhur)**, pasqyron përmbledhtazi vlerësimin gjinor në përmbajtjet audiovizive të monitoruara e të transmetuara nga OSHMA-të për fushatën zgjedhore gjatë periudhës 14 prill – 5 maj 2023.

#### **Propozim:**

**AMA i propozon KQZ-së që t'i tërheqë vëmendjen OSHMA-ve për të rritur nivelin e ndjeshmërisë ndaj kriterit të përfaqësimit gjinor në fushatën zgjedhore.**

#### **VII. Të dhënat mbi transmetimet e drejtpërdrejta (live):**

Në **Tabelën nr. 5 të Shtojcës nr. 1 (bashkëlidhur)**, jepen të dhëna mbi transmetimet e drejtpërdrejta (live) që kanë lidhje me fushatën zgjedhore në periudhën 14 prill – 5 maj 2023.

#### **VIII. Monitorimi i përkohshëm i OSHMA-ve:**

Në vijim të Shtojcës nr. 1, bashkëlidhur, jepen tabelat për monitorimin 1 javor (28 prill – 4 maj 2023) të OSHMA-ve me përzgjedhje të përkohshme, si sipërpërmendur.

Edhe për këto OSHMA, AMA ka përcjellë çdo ditë në KQZ raportet përkatëse të monitorimit, me të dhënat si më poshtë vijon:

- Kohën e monitorimit të secilit OSHMA, për transmetimet në orën 08.00-24.00;
- Minutazhin e transmetimeve për secilin subjekt zgjedhor;
- Hapësirën për çdo subjekt politik;
- Radhën e vendosjes së kandidatëve në edicionet informative;
- Transmetimet e drejtpërdrejta (*live*);
- Raportin gjinor sa i takon mbulimit mediatic të kandidatëve.

Në datën 5 maj 2023, ka filluar monitorimi për javën e katërt të OSHMA-ve të përzgjedhura.



## PËR KËTO ARSYE:

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), në mbështetje të nenit 19, pika 16 të ligjit nr 97/2013, datë 19.03.2013, "Për mediat audiovizive në RSH", të ndryshuar, nenet 77-85 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe vendimit nr.2, datë 30.01.2021, të Komisionit Rregullator të KQZ-së "Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të medias audio dhe audiovizive",

## VENDOSI:

1. Miratimin e raportit të AMA-s së mbulimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të për periudhën 1-5 maj 2023.
2. T'i rekomandojë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve:
  - i. Të procedojë me marrje mase administrative, sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, për 5 (pesë) OSHMA-të që nuk kanë paraqitur asnjë regjistrim pranë AMA-s, për periudhën 1 - 5 maj 2023.
  - ii. Të procedojë me marrje mase administrative për radiotelevizionin publik (RTSH) për mosrespektim të raporteve kohore të barabarta për të gjitha partitë parlamentare, sipas mbulimit konkret që i kanë bërë fushatës zgjedhore, sipas dispozitave të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, për periudhën 14 prill - 5 maj 2023.
  - iii. Të kërkojë prej OSHMA-ve që, sipas mbulimit konkret që i kanë bërë fushatës në periudhën 14 prill - 5 maj 2023, të bëjnë në vijim kompensimin në kohë transmetimi në edicionet informative për efekt balancimi.
  - iv. Të kërkojë prej 2 (dy) OSHMA-ve ndërprerjen e transmetimit të reklamave politike përtej minutazhit të përcaktuar e të lejuar në Kodin Zgjedhor, të ndryshuar.
  - v. Të kërkojë prej 6 (gjashtë) OSHMA-ve ndërprerjen e transmetimeve të reklamave politike në kohën e ndaluar, sipas dispozitave të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar.
  - vi. Të kërkojë nga 1 (një) OSHMA që të ndërpresë transmetimin e reklamave politike brenda edicionit të lajmeve.
  - vii. Të procedojë me tërheqje vëmendje për OSHMA-të, për të rritur nivelin e ndjeshmërisë ndaj kriterit të përfaqësimit gjinor në fushatën zgjedhore.
3. Ngarkohet administrata e AMA-s për njoftimin e këtij vendimi pranë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetar:**

**Zëvendëskryetar:**

**Armela**

**Desada**

**KRASNIQI**

**METAJ**



AUTORITETI I  
MEDIAVE  
AUDIOVIZIVE

Rr. "Papa Gjon Pali II", Nr. 15, 1010, Tiranë | [www.ama.gov.al](http://www.ama.gov.al)  
Tel. +355 4 2233370 | Email. [info@ama.gov.al](mailto:info@ama.gov.al)



Anëtarë:

Aurela  
Besian  
Gjergji  
Jetmir  
Joana

BICJA  
ZOGAJ  
HAMITI  
HALILAJ  
ALLUSHI



AUTORITETI I  
MEDIAVE  
AUDIOVIZIVE

Rr. "Papa Gjon Pali II", Nr. 15, 1010, Tiranë | [www.ama.gov.al](http://www.ama.gov.al)  
Tel. +355 4 2233370 | Email. [info@ama.gov.al](mailto:info@ama.gov.al)





Autoriteti Mediate Audiovizive  
 Subjekti - Lajme  
 Koha e plotë në minuta  
 14/04/2023 - 05/05/2023  
 OSHMA me monitorim të përhershëm

TABELA NR. 1

| Subjekti                                                   | CNA           | Kanali 7      | Klan News      | Panorama TV    | Syri TV       | A2 CNN      | Top News       | Shifak TV      | Abc News       | News 24       | Report TV     | Ora News   | Klan TV      |
|------------------------------------------------------------|---------------|---------------|----------------|----------------|---------------|-------------|----------------|----------------|----------------|---------------|---------------|------------|--------------|
| BF Bashkë Fitojmë                                          | 1762          | 1360.7        | 714.95         | 896.72         | 1762.4        | 602.88      | 271.17         | 1313.22        | 277.57         | 461.37        | 141.33        | 306.75     | 231.4        |
| PS Partia Socialiste                                       | 1469.3        | 1327.3        | 663.32         | 627.18         | 226.32        | 566.77      | 762.48         | 6.9            | 512.5          | 195.65        | 323.83        | 252.9      | 267.1        |
| PD Partia Demokratike                                      | 982.88        | 853.42        | 657.07         | 444.92         | 10.35         | 239.72      | 383.05         | 0              | 318.83         | 162.82        | 279.38        | 134.32     | 167.3        |
| KQZ Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve                         | 206.72        | 240.68        | 313.77         | 154.8          | 102.48        | 161.32      | 97.9           | 13.33          | 164.55         | 102.65        | 149.27        | 77.18      | 40.7         |
| PR Partia Republikane Shqiptare                            | 80.75         | 9.2           | 192.37         | 83.05          | 52.1          | 33.27       | 37.33          | 0              | 6.47           | 40.03         | 12.33         | 44.22      | 0            |
| PDIU Partia Drejtësi, Integritim dhe Unitet                | 45.95         | 0             | 57.82          | 0              | 0             | 0           | 28.78          | 0              | 34.08          | 17.68         | 21.87         | 1.87       | 0            |
| PAA Partia Agrare Ambientaliste                            | 13.17         | 0             | 31.88          | 17.53          | 9.4           | 0.65        | 11.1           | 0              | 2              | 8.8           | 0.73          | 4.02       | 0            |
| NTH Nisma Thurje                                           | 0             | 0             | 0              | 11.78          | 0             | 10.38       | 0              | 0              | 0              | 5.08          | 8.53          | 16.4       | 0            |
| PSD Partia Social Demokrate                                | 0             | 0             | 0              | 0              | 0             | 5.57        | 0              | 0              | 0              | 0             | 0             | 0          | 0            |
| PLB Partia Lëvizja Bashkë                                  | 8.5           | 0             | 0              | 0              | 0             | 0           | 0              | 0              | 0              | 0             | 0             | 2.27       | 0            |
| LZHK Lëvizja për Zhvillim Kombëtar                         | 0             | 0             | 0              | 0              | 3.73          | 1.4         | 1.65           | 0              | 4.5            | 0             | 0             | 1.07       | 0            |
| PKSH Partia Komuniste e Shqipërisë                         | 0             | 0             | 0              | 0              | 0             | 0           | 0              | 0              | 0              | 0             | 0             | 0          | 0            |
| PMEGA Partia Minoriteti Etnik Grek për të Kolegji Zgjedhor | 0             | 0             | 0              | 0              | 0             | 0           | 0              | 0              | 0              | 8.03          | 0             | 0          | 0            |
| PL Partia e Lirisë                                         | 0             | 0             | 0              | 0              | 2.27          | 0           | 0              | 0              | 0              | 0             | 0             | 0          | 0            |
| BD Partia Bindja Demokratike                               | 0             | 0             | 0              | 0              | 0             | 0           | 0              | 0              | 1.55           | 0             | 0             | 0          | 0            |
| PAAK Partia Aleanca Arbnore Kombëtare                      | 0             | 0             | 0.88           | 0              | 0             | 0           | 0              | 0              | 0              | 0             | 0             | 0          | 0            |
| PFM Partia Fronti i Majtë                                  | 0             | 0             | 0              | 0              | 0             | 0           | 0              | 0              | 0              | 0             | 0             | 0          | 0            |
| <b>Totali</b>                                              | <b>4569.3</b> | <b>3791.4</b> | <b>2632.06</b> | <b>2235.98</b> | <b>2169.1</b> | <b>1622</b> | <b>1593.46</b> | <b>1333.45</b> | <b>1322.05</b> | <b>1002.1</b> | <b>937.27</b> | <b>841</b> | <b>706.4</b> |



Autoriteti Mediave Audiovizive  
 Subjekti - Lajme  
 Koha e plotë në minuta  
 14/04/2023 - 05/05/2023  
 OSHMA me monitorim të përhershëm

TABELA NR. 1

| Fax News | Vizion Plus | Rtv Ora | RTSH 1 | Euronews Albania | MCN   | RTSH 24 | Top Channel | Klan Plus | Radio Tirana | Top Albania Radio | RTSH 2 | Radio Klan | Club Fm | Totali  |
|----------|-------------|---------|--------|------------------|-------|---------|-------------|-----------|--------------|-------------------|--------|------------|---------|---------|
| 185.77   | 185.03      | 166.8   | 158.5  | 123.58           | 131   | 55.3    | 78.82       | 87.68     | 25.93        | 27.92             | 11.75  | 4.83       | 1.8     | 11347.1 |
| 181.78   | 202.1       | 160.85  | 192.1  | 149.4            | 82.03 | 133.62  | 154.38      | 83.52     | 54.07        | 40.72             | 30.87  | 5.47       | 3.23    | 8675.74 |
| 173.43   | 111.58      | 99.62   | 108.1  | 109.53           | 92.3  | 35.22   | 54.42       | 63.8      | 50.23        | 14.82             | 3.48   | 1.05       | 0.8     | 5552.36 |
| 115.6    | 24.08       | 53.25   | 23.2   | 58.28            | 61.92 | 137.02  | 26.67       | 33.12     | 13.32        | 2.93              | 4.3    | 2.1        | 1.63    | 2382.77 |
| 14.47    | 0           | 20.47   | 20.43  | 14.02            | 1.7   | 5.35    | 0           | 17.55     | 0            | 0                 | 4.93   | 0.45       | 0       | 690.49  |
| 4        | 0           | 2.15    | 0      | 2.4              | 0     | 0       | 0           | 0         | 0            | 0                 | 0      | 0          | 0       | 216.6   |
| 3.6      | 0           | 2.52    | 1.75   | 0                | 0     | 0       | 0           | 2.63      | 0            | 0                 | 0      | 0          | 0       | 109.78  |
| 5.93     | 0           | 11.08   | 0      | 11.1             | 4.22  | 0       | 0           | 0         | 0            | 0                 | 0      | 0          | 0       | 84.5    |
| 0        | 0           | 0       | 0      | 0                | 0     | 0       | 0           | 0         | 0            | 0                 | 0      | 0          | 0       | 5.57    |
| 0.75     | 0           | 0.87    | 0      | 7.97             | 1.93  | 0       | 0           | 0         | 0            | 0                 | 0      | 0          | 0       | 22.29   |
| 4.8      | 0           | 1.55    | 0      | 0                | 0     | 0       | 0           | 0         | 0            | 0                 | 0      | 0          | 0       | 18.7    |
| 0.58     | 0           | 0       | 0      | 0                | 0     | 0       | 0           | 0         | 0            | 0                 | 0      | 0          | 0       | 0.58    |
| 0.75     | 0           | 0       | 0      | 0                | 0     | 0       | 0           | 0         | 0            | 0                 | 0      | 0          | 0       | 0.75    |
| 0        | 0           | 0       | 0      | 0                | 0     | 0       | 0           | 0         | 0            | 0                 | 0      | 0          | 0       | 8.03    |
| 0        | 0           | 0       | 0      | 0                | 0     | 0       | 0           | 0         | 0            | 0                 | 0      | 0          | 0       | 2.27    |
| 0        | 0           | 0       | 0      | 0                | 0     | 0       | 0           | 0         | 0            | 0                 | 0      | 0          | 0       | 1.55    |
| 0        | 0           | 0       | 0      | 0                | 0     | 0       | 0           | 0         | 0            | 0                 | 0      | 0          | 0       | 0.88    |
| 0.75     | 0           | 0       | 0      | 0                | 0     | 0       | 0           | 0         | 0            | 0                 | 0      | 0          | 0       | 0.75    |
| 692.21   | 522.79      | 519.16  | 504    | 476.28           | 375.1 | 366.51  | 314.29      | 288.3     | 143.55       | 86.39             | 55.33  | 13.9       | 7.46    | 29120.7 |





Autoriteti Mediave Audiovizive

Aktori - Lajme

Koha sinkron në minuta

14/04/2023 - 05/05/2023

OSHMA me monitorim të përhershëm

TABELA NR. 1/1

| Aktori             | CNA    | Kanali 7 | Panorama Tv | Klan News | A2 CNN | Syri Tv | Shijak TV | Top News |
|--------------------|--------|----------|-------------|-----------|--------|---------|-----------|----------|
| Sali Berisha       | 357.02 | 437.02   | 196.23      | 166.42    | 221.05 | 278.7   | 274.37    | 108      |
| Edi Rama           | 356.72 | 419.83   | 138.63      | 159.12    | 197.47 | 89.18   | 6.9       | 106.42   |
| Enkelejd Alibeaj   | 291.1  | 354.07   | 149.53      | 210.35    | 71.68  | 6.4     | 0         | 123.75   |
| Erion Veliaj       | 330.25 | 259.18   | 125.65      | 123.68    | 169.28 | 0.82    | 0         | 135.02   |
| Belind Këlliçi     | 279.38 | 346.2    | 20.95       | 99.95     | 86.13  | 135.5   | 216.8     | 17.22    |
| Roland Bejko       | 207.48 | 183.82   | 69.17       | 108.43    | 71.83  | 0       | 0         | 46.5     |
| Ilir Meta          | 127.7  | 30.38    | 99.23       | 21.55     | 42.88  | 59.72   | 69.2      | 2.33     |
| Fatmir Mediu       | 36.83  | 6.9      | 46.37       | 86.83     | 25.18  | 17.73   | 0         | 18.55    |
| Ilirjan Celibashi  | 27.8   | 30.78    | 0           | 15.1      | 10.62  | 0       | 0         | 4.83     |
| Damian Gjikhuri    | 36.2   | 0        | 0           | 0         | 8.53   | 5.03    | 0         | 59.7     |
| Bardh Spahia       | 16.67  | 0        | 1.67        | 5.77      | 2.22   | 56.68   | 52.2      | 0        |
| Belinda Balluku    | 44.13  | 10.9     | 0           | 2.33      | 3.42   | 0       | 0         | 13.45    |
| Luçiano Boçi       | 14.8   | 0        | 19.9        | 0         | 0      | 11.5    | 55.2      | 0        |
| Emiriana Sako      | 26.75  | 4.77     | 0           | 0         | 2.22   | 0.53    | 0         | 33.87    |
| Mirela Karabina    | 21.27  | 0        | 3.92        | 20.2      | 0      | 0       | 0         | 16.82    |
| Ledina Mandia      | 13.75  | 0        | 13.38       | 0         | 0      | 5.37    | 16.7      | 0        |
| Gazmend Bardhi     | 14.85  | 8.27     | 14.08       | 2.17      | 0      | 0       | 0         | 8.42     |
| Ogerta Manastirliu | 44.02  | 13.7     | 0           | 1.52      | 0      | 0.67    | 0         | 2.33     |
| Silvi Bardhi       | 24.57  | 0        | 0           | 0         | 0      | 7.92    | 26.97     | 0        |
| Gledian Llatja     | 8.4    | 0        | 0           | 0         | 0      | 0.23    | 0         | 35.93    |
| Ermal Dredha       | 0      | 17.07    | 29.42       | 0         | 2.12   | 0.28    | 0         | 0        |
| Eriselda Çelaj     | 38.32  | 7.08     | 0           | 8.78      | 0      | 0       | 0         | 7.8      |
| Shpëtim Idrizi     | 5.33   | 0        | 0           | 11.6      | 0      | 0       | 0         | 11.22    |
| Igli Cara          | 0      | 7.88     | 16.63       | 0         | 2.5    | 16.07   | 14.7      | 0        |
| Ivi Kaso           | 6      | 4.97     | 14.38       | 0         | 4.45   | 11.8    | 12.75     | 0        |
| Bledi Çuçi         | 25.13  | 14       | 0           | 10.12     | 0      | 0.8     | 0         | 6        |
| Evis Kushi         | 14.57  | 10.8     | 0           | 3.25      | 0      | 1.47    | 0         | 2.5      |
| Delinda Ibrahimaj  | 13.15  | 0        | 0           | 6.07      | 9      | 0       | 0         | 3.17     |
| Floriana Garo      | 24.55  | 0        | 7.52        | 0         | 0      | 8.42    | 12.27     | 0        |
| Taulant Balla      | 25     | 0        | 2.12        | 0         | 0      | 0       | 0         | 13.77    |
| Avenir Peka        | 6.8    | 0        | 12.3        | 0         | 0      | 6.27    | 13.1      | 0        |
| Agron Duka         | 0      | 0        | 8.78        | 14.88     | 0.45   | 2.87    | 0         | 5.47     |
| Armando Subashi    | 0      | 6.52     | 20.07       | 0         | 0      | 0       | 0         | 0        |
| Ervin Salianji     | 0      | 0        | 12.9        | 6.67      | 0      | 5.68    | 0         | 0        |
| Jola Hysaj         | 20.07  | 0        | 0           | 0         | 0      | 6.8     | 11        | 0        |
| Benet Beci         | 9.75   | 0        | 0           | 4.4       | 2.48   | 1.15    | 0         | 0        |
| Jorgo Goro         | 0      | 28.35    | 0           | 0         | 0      | 0       | 0         | 0        |
| Indrit Hoxha       | 3.2    | 0        | 12.45       | 0         | 0      | 6.4     | 0         | 0        |
| Miftar Dauti       | 0      | 0        | 13.6        | 0         | 3      | 8.75    | 0         | 4.9      |
| Evdar Kodheli      | 0      | 5.95     | 0           | 0         | 0      | 13.68   | 0         | 0        |
| Enno Bozdo         | 28.17  | 0        | 0           | 0         | 0      | 4.28    | 0         | 0        |
| Admir Sinamati     | 0      | 0        | 1.13        | 0         | 2      | 24.38   | 0         | 0        |





|                  |       |      |       |      |      |       |      |      |
|------------------|-------|------|-------|------|------|-------|------|------|
| Tedi Blushi      | 0     | 0    | 4.58  | 0    | 0    | 1.4   | 22.8 | 0    |
| Hysni Sharra     | 0     | 20.8 | 0     | 0    | 2.03 | 1.08  | 0    | 0    |
| Arjan Hoxha      | 0     | 0    | 1.63  | 0    | 0    | 21.78 | 0    | 0    |
| Endri Shabani    | 0     | 0    | 3.97  | 0    | 2.68 | 0     | 0    | 0    |
| Luan Baçi        | 18.33 | 0    | 1     | 0    | 0    | 6.97  | 0    | 0    |
| Lajla Përnaska   | 17.78 | 0    | 0     | 0    | 0    | 0     | 0    | 0    |
| Flamur Noka      | 9.9   | 0    | 14.12 | 0    | 1.37 | 0.87  | 0    | 0    |
| Klomentina Drini | 0     | 0    | 0     | 3.33 | 0    | 0     | 0    | 0    |
| Ilir Xhakolli    | 0     | 0    | 23.75 | 0    | 0    | 1.48  | 0    | 0    |
| Niko Peleshi     | 9.57  | 0    | 0     | 0    | 0    | 0     | 0    | 0    |
| Albana Vokshi    | 0     | 0    | 6.05  | 0    | 0    | 6.25  | 4    | 3.6  |
| Zef Hila         | 0     | 0    | 0     | 0    | 0    | 19.3  | 0    | 0    |
| Sotiraq Filo     | 10.03 | 0    | 0     | 0    | 2.1  | 3.75  | 0    | 0    |
| Fisnik Qosja     | 0     | 0    | 13.77 | 0    | 0    | 2.47  | 0    | 0    |
| Nard Ndoka       | 9.4   | 0    | 0     | 0    | 0    | 0.43  | 5.87 | 0    |
| Ina Zhupa        | 0     | 0    | 16    | 0    | 0    | 1.6   | 0    | 0    |
| Pano Soko        | 0     | 0    | 2.68  | 0    | 3.38 | 0     | 0    | 0    |
| Mesila Doda      | 0     | 0    | 0     | 9.15 | 0    | 0     | 0    | 4.58 |
| Gledian Llataj   | 0     | 0    | 0     | 0    | 0    | 0     | 0    | 0    |
| Pranvera Rizaj   | 0     | 0    | 0     | 0    | 0    | 0     | 0    | 0    |
| Akil Kraja       | 0     | 0    | 0     | 0    | 0    | 3.13  | 7.8  | 0    |
| Pashk Gjoni      | 0     | 0    | 0     | 0    | 0    | 5.23  | 0    | 0    |
| Ledina Alolli    | 0     | 0    | 0     | 6.07 | 2    | 3.95  | 0    | 0    |
| Agron Kapllanaj  | 0     | 0    | 0     | 0    | 0    | 0     | 0    | 0    |
| Adriana Kalaja   | 0     | 0    | 2.4   | 0    | 0    | 8.95  | 0    | 0    |
| Klevis Balliu    | 9.15  | 0    | 0     | 0    | 0    | 1.08  | 0    | 2.4  |
| -- Pa kategori   | 0     | 0    | 3.3   | 0    | 0    | 0     | 0    | 0    |
| Zija Ismaili     | 0     | 0    | 0     | 0    | 2    | 6.82  | 0    | 0    |
| Fredi Beleri     | 0     | 0    | 0     | 0    | 0    | 11.08 | 0    | 0    |
| Dashamir Shehi   | 0     | 0    | 0     | 0    | 1.2  | 1.4   | 0    | 0.9  |
| Monika Kryemadhi | 0     | 0    | 0     | 0    | 7.3  | 1.58  | 0    | 0    |
| Ismail Uka       | 0     | 0    | 0     | 0    | 3.97 | 0.33  | 0    | 0    |
| Arbi Agalliu     | 0     | 0    | 3     | 0    | 0    | 0     | 0    | 0    |
| Pjerin Ndreu     | 0     | 0    | 0     | 0    | 0    | 1.53  | 0    | 0    |
| Mateo Spaho      | 0     | 0    | 0     | 0    | 0    | 0     | 0    | 0    |
| Mirela Kumbaro   | 0     | 0    | 0     | 0    | 0    | 1.95  | 0    | 0    |
| Jozefina Topalli | 0     | 0    | 6     | 0    | 0    | 2.07  | 0    | 0    |
| Jorida Tabaku    | 0     | 0    | 7.42  | 0    | 0    | 0     | 0    | 0    |
| Andi Lila        | 7.3   | 0    | 0     | 0    | 0    | 0     | 0    | 0    |
| Dallendyshe Bici | 0     | 0    | 7     | 0    | 0    | 0     | 0    | 0    |
| Fatmir Xhafaj    | 0     | 0    | 5.67  | 0    | 0    | 0     | 0    | 0    |
| Arlind Qori      | 0     | 0    | 0     | 0    | 0    | 0     | 0    | 0    |
| Safije Alushaj   | 0     | 0    | 0     | 0    | 0    | 5.37  | 0    | 0    |
| Eduart Sharka    | 0     | 0    | 0     | 0    | 0    | 4.55  | 0    | 0    |
| Rahim Spahiu     | 0     | 0    | 0     | 0    | 3.87 | 0     | 0    | 0    |
| Adriatik Mema    | 0     | 0    | 0     | 0    | 0    | 0     | 0    | 0    |
| Adriatik Spahiu  | 0     | 0    | 1.25  | 0    | 0    | 0     | 0    | 0    |
| Agron Malaj      | 0     | 0    | 0     | 0    | 5.35 | 0     | 0    | 0    |
| Dorjan Lani      | 0     | 0    | 0     | 0    | 1.9  | 2.15  | 0    | 0    |
| Rakip Suli       | 0     | 0    | 0     | 0    | 0    | 0     | 0    | 0    |
| Ervin Demo       | 0     | 0    | 0     | 0    | 2.2  | 0     | 0    | 0    |



|                  |      |     |      |      |      |      |      |      |
|------------------|------|-----|------|------|------|------|------|------|
| Safet Gjici      | 0    | 0   | 0    | 0    | 2    | 2.48 | 0    | 0    |
| Besnik Duzhaj    | 0    | 0   | 1.73 | 0    | 2    | 0    | 0    | 0    |
| Behar Haxhiu     | 0    | 0   | 0    | 0    | 0    | 3.77 | 0    | 0    |
| Beqir Mulaj      | 0    | 0   | 0    | 0    | 0    | 0    | 0    | 1.75 |
| Blendi Klosi     | 0    | 4.2 | 0    | 0    | 0    | 0    | 0    | 0    |
| Albert Mëlyshi   | 0    | 0   | 0    | 0    | 0    | 2.48 | 0    | 0    |
| Myslim Murrizi   | 0    | 0   | 0    | 0    | 0    | 3.98 | 0.33 | 0    |
| Mariglen Disha   | 0    | 0   | 0    | 0    | 0    | 0    | 0    | 1.8  |
| Redjan Krali     | 0    | 0   | 0    | 0    | 0    | 1.78 | 0    | 0    |
| Bedri Hoxha      | 0    | 0   | 1.53 | 0    | 0    | 1.47 | 0    | 0    |
| Tritan Shehu     | 0    | 0   | 0    | 0    | 0    | 2.92 | 0    | 0    |
| Ilir Mehmeti     | 0    | 0   | 0.78 | 0    | 0    | 1.95 | 0    | 0    |
| Elva Margariti   | 2.67 | 0   | 1.17 | 0    | 0    | 0    | 0    | 0    |
| Eduard Sharka    | 0    | 0   | 0    | 0    | 0    | 1.12 | 0    | 0    |
| Ilda Dhori       | 0    | 0   | 0    | 0    | 0    | 3.8  | 0    | 0    |
| Skënder Gjuci    | 0    | 0   | 0    | 0    | 3.4  | 0    | 0    | 0    |
| Edith Harxhi     | 0    | 0   | 0    | 0    | 0    | 2.57 | 0    | 0    |
| Orjola Pampuri   | 0    | 0   | 0    | 0    | 0    | 0    | 0    | 0    |
| Majlinda Cara    | 0    | 0   | 3.4  | 0    | 0    | 0    | 0    | 0    |
| Flamur Golemi    | 0    | 0   | 0    | 0    | 2    | 0    | 0    | 0    |
| Dashnor Sula     | 0    | 0   | 2.23 | 0    | 0    | 1.13 | 0    | 0    |
| Saimir Korreshi  | 0    | 0   | 0    | 0    | 0    | 3    | 0.25 | 0    |
| Tomor Alizoti    | 0    | 0   | 0    | 0    | 0    | 2.53 | 0    | 0    |
| Suzana Topi      | 0    | 0   | 0    | 0    | 0    | 3.1  | 0    | 0    |
| Ilir Alimehmeti  | 0    | 0   | 0    | 0    | 0    | 2.32 | 0    | 0    |
| Arben Cuko       | 0    | 0   | 0    | 0    | 0    | 2.7  | 0    | 0    |
| Alfred Lela      | 0    | 0   | 0    | 0    | 0    | 0    | 0    | 0    |
| Alfred Gega      | 0    | 0   | 0    | 0    | 0    | 2.58 | 0    | 0    |
| Lindita Metaliaj | 0    | 0   | 0    | 0    | 0    | 2.02 | 0    | 0    |
| Rexhe Byberi     | 0    | 0   | 0    | 0    | 2    | 0    | 0    | 0    |
| Edison Memolla   | 0    | 0   | 0    | 0    | 0    | 0    | 0    | 0    |
| Josif Gorrea     | 0    | 0   | 0    | 0    | 0    | 0    | 0    | 0    |
| Isa Ramaj        | 0    | 0   | 0    | 0    | 0    | 0    | 0    | 0    |
| Edi Paloka       | 0    | 0   | 0    | 0    | 0    | 0    | 0    | 0    |
| Eridian Salianji | 0    | 0   | 0    | 1.67 | 0    | 0    | 0    | 0    |
| Vangjel Dule     | 0    | 0   | 0    | 0    | 0    | 1.67 | 0    | 0    |
| Doris Madhi      | 0    | 0   | 1.65 | 0    | 0    | 0    | 0    | 0    |
| Dëfrim Fiku      | 0    | 0   | 0    | 0    | 0    | 0    | 0    | 0    |
| Kristjan Shkreli | 0    | 0   | 0    | 0    | 0    | 0    | 0    | 0    |
| Elton Arbana     | 0    | 0   | 0    | 0    | 1.58 | 0    | 0    | 0    |
| Rezeart Tusha    | 0    | 0   | 0    | 0    | 1.53 | 0    | 0    | 0    |
| Sokol Guga       | 0    | 0   | 0    | 0    | 0    | 0    | 0    | 0    |
| Ulsi Manja       | 0    | 0   | 0    | 0    | 0    | 0    | 0    | 0    |
| Thanas Maneka    | 0    | 0   | 0    | 0    | 0    | 1.42 | 0    | 0    |
| Adil Xhelili     | 0    | 0   | 0    | 0    | 0    | 0    | 0    | 0    |
| Dava Marku       | 0    | 0   | 0    | 0    | 0    | 0    | 0    | 0    |
| Qerim Ismailaj   | 0    | 0   | 0    | 0    | 0    | 0    | 0    | 0    |
| Fabian Topollaj  | 0    | 0   | 0    | 0    | 0    | 0    | 0    | 0    |
| Silva Caka       | 0    | 0   | 0    | 0    | 0    | 0    | 0    | 0    |
| Toni Gogu        | 0    | 0   | 0    | 0    | 0    | 0    | 0    | 0    |
| Zini Tollozhina  | 0    | 0   | 0    | 0    | 0    | 1.17 | 0    | 0    |



|                  |               |               |                |                |               |              |               |            |
|------------------|---------------|---------------|----------------|----------------|---------------|--------------|---------------|------------|
| Dashamir Sula    | 0             | 0             | 0              | 0              | 0             | 1.13         | 0             | 0          |
| Andis Salla      | 0             | 0             | 0              | 0              | 0             | 0            | 0             | 0          |
| Grisejda Myslimi | 0             | 0             | 0              | 0              | 0             | 1.05         | 0             | 0          |
| Besmir Veli      | 0             | 1.02          | 0              | 0              | 0             | 0            | 0             | 0          |
| Kreshnik Hajdari | 0             | 0             | 0              | 0              | 0             | 0            | 0             | 0          |
| Ilirjan Koxhaj   | 0             | 0             | 0              | 0              | 0             | 0            | 0             | 0          |
| Olta Xhaçka      | 0             | 0             | 0.85           | 0              | 0             | 0            | 0             | 0          |
| Besian Ajazi     | 0             | 0             | 0              | 0              | 0             | 0            | 0             | 0          |
| Agron Loka       | 0             | 0             | 0              | 0              | 0.75          | 0            | 0             | 0          |
| Bukurosh Maçi    | 0             | 0             | 0              | 0              | 0             | 0            | 0             | 0          |
| Leonard Hide     | 0             | 0             | 0              | 0              | 0             | 0            | 0             | 0          |
| Leonard Rakipaj  | 0             | 0             | 0              | 0              | 0             | 0.73         | 0             | 0          |
| Shefki Çota      | 0             | 0             | 0              | 0              | 0             | 0            | 0             | 0          |
| Juliana Memaj    | 0             | 0             | 0              | 0              | 0             | 0            | 0             | 0          |
| Edmond Spaho     | 0             | 0             | 0              | 0              | 0             | 0            | 0             | 0          |
| Dritan Sula      | 0             | 0             | 0              | 0              | 0             | 0            | 0             | 0          |
| Preç Zogaj       | 0             | 0             | 0              | 0              | 0             | 0            | 0             | 0          |
| Tërmet Peçi      | 0             | 0             | 0              | 0              | 0.55          | 0            | 0             | 0          |
| Skënder Muço     | 0             | 0             | 0              | 0              | 0             | 0            | 0             | 0          |
| Shkëlqim Hoxha   | 0             | 0             | 0              | 0              | 0             | 0            | 0             | 0          |
| Enriketa Papa    | 0             | 0             | 0              | 0              | 0             | 0            | 0             | 0          |
| Erjon Braçe      | 0             | 0             | 0              | 0              | 0             | 0            | 0             | 0          |
| Elvis Hajdërilli | 0             | 0             | 0              | 0              | 0             | 0            | 0             | 0          |
| Petref Skënderaj | 0             | 0             | 0              | 0              | 0             | 0            | 0             | 0          |
| Kastriot Piroli  | 0             | 0             | 0              | 0              | 0             | 0.32         | 0             | 0          |
| Ilir Metaj       | 0             | 0.3           | 0              | 0              | 0             | 0            | 0             | 0          |
| Fatmir Gjoci     | 0             | 0             | 0              | 0              | 0             | 0.28         | 0             | 0          |
| Greta Badeli     | 0             | 0             | 0              | 0              | 0             | 0            | 0             | 0          |
|                  |               |               |                |                |               |              |               |            |
| <b>Totali</b>    | <b>2593.9</b> | <b>2234.8</b> | <b>1186.94</b> | <b>1109.41</b> | <b>995.67</b> | <b>979.1</b> | <b>823.21</b> | <b>803</b> |





Autoriteti Mediave Audiovizive

Aktori - Lajme

Koha sinkron në minuta

14/04/2023 - 05/05/2023

OSHMA me monitorim të përhershëm

TABELA NR. 1/1

| Abc News | Report TV | Ora News | News 24 | Vizion Plus | Klan Tv | Rtv Ora | ironews Alban | RTSH 1 | Fax News |
|----------|-----------|----------|---------|-------------|---------|---------|---------------|--------|----------|
| 25.82    | 3.6       | 62.02    | 89.97   | 53.17       | 56.87   | 36.53   | 39.77         | 41.33  | 36.75    |
| 140.53   | 85.52     | 61.48    | 41.22   | 57          | 50.47   | 50.9    | 39.48         | 45.27  | 32.35    |
| 67.62    | 27.03     | 58.4     | 59.22   | 40.67       | 47.68   | 44.32   | 38.65         | 30.8   | 49.47    |
| 91.13    | 44.05     | 0        | 41.67   | 36.88       | 39.42   | 0       | 40.33         | 29.68  | 33.88    |
| 75.22    | 0         | 45.22    | 26.33   | 44.9        | 31.58   | 26.1    | 25.17         | 26.35  | 17.17    |
| 56.02    | 64.67     | 17       | 21.38   | 22.97       | 22.67   | 9.75    | 17.77         | 22.48  | 29.67    |
| 9.45     | 10.75     | 11.88    | 30.45   | 5.07        | 0.6     | 10      | 12.18         | 20.35  | 4.92     |
| 1.8      | 5.07      | 25.12    | 14.42   | 0.37        | 0.62    | 12.98   | 11.7          | 10.87  | 2.93     |
| 33.58    | 27.37     | 8.87     | 0       | 0           | 5.48    | 0       | 0             | 0      | 0        |
| 1.4      | 6.32      | 17.53    | 3.9     | 0           | 1.85    | 14.82   | 0             | 5.68   | 5.9      |
| 0        | 10.5      | 0        | 0.93    | 0           | 0       | 0       | 0             | 0.35   | 0        |
